YAHR
YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

2021

ANALIZË HULUMTUESE

mbi nevojat dhe kërkesat e qytetareve të Komunës së Lipjanit dhe Shtimes

2022/24

Janar 2022

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT

KCSF
FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

COPYRIGHT © 2021. Youth Association for Human Rights (YAHR).
***Youth Association for Human Rights** i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.*
Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:
Adresa: Rruga Tahir Sinani,
14000, Lipjan,
Kosovë
Tel .: +383 (0) 44 786 414
E-mail: info.yahr@gmail.com
Web:www.ngoyahr.webbly.com

***Autor:** Bekim Krasniqi*

***Asistentë të hulumtimit**: Erëblina Salihu*

***Faqosja dhe dizajni:** YAHR*

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje 3
procesi i planifikimit te buxhetit 4
Komuna e Lipjanit 6
Kërkesat dhe prioritetet e qytetareve gjatë vitit 2021 6
Përfshirja e prioriteteve të qytetareve në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022/24 9
KOMUNA E SHTIMES 10
Kërkesat dhe prioritetet e qytetareve gjatë vitit 2021 10
Përfshirja e prioriteteve të qytetareve në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022/24 11
Shtojcat: 12
Organizata YAHR: 16
Burimet: 17

HYRJE

Të nderuar qytetarë të Komunës së Lipjanit dhe Shtimes,

Organizata Joqeveritare YAHR në kuadër të Aktiviteteve monitoruese ka bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjani dhe të Shtimes gjatë periudhës Maj 2021- Janar 2022.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje, Buxhet me pjesëmarrje është një trajtim i ri që sjellë komunitetet lokale më afër procesit të vendimmarrjes lidhur me buxhetin publik. Vendimmarrja prezantohet mbi menaxhimin e të gjithave ose të një pjese të burimeve aktive të financave publike të pushtet it lokal. Buxhet imi me pjesëmarrje ka për qëllim ngritjen e transparencës . Ai synon në mënyrë më specifike, në procesin e hartimit të buxhetit për investime. Ky proces përpiqet të zhvilloje një sërë instrumentesh të cilat lidhin buxhetin me vendim – marrjen, bazuar në konsultimet me publikun e gjerë.

Bekim Krasniqi

Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

PROCESI I PLANIFIKIMIT TE BUXHETIT

Në planifikimin e buxhetit të komunës përfshihen një mori e institucioneve sikurse Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe Ministria e Financave dhe institucione të pushtetit lokal si kryetari dhe kuvendi i Komunës. Gjithsesi ndikim të madh në këtë proces e kanë vetë qytetarët.

Deri me 30 prill, Qeveria e Kosovës i dorëzon Kuvendit të Kosovës Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Ministria e Financave deri më datën 15 maj nxjerrë Qarkoren buxhetore të 1-rë, që përmban udhëzimet për procesin buxhetor, kufijtë buxhetor, kalendarin buxhetor.

Deri më 30 qershor, komuna duhet t`ia dorëzojë Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të miratuar nga kuvendi i komunës Ministrisë së Financave.

Planifikimi vazhdon me dorëzimin nga ana e zyrtarit kryesor të financave tek secili departament komunal i Qarkores së 1-rë buxhetore të brendshme komunale ku kërkohet përgatitja e propozimeve buxhetore dhe dorëzimi i tyre tek ZKF. Pastaj, ZKF departamenteve ua dorëzon Qarkoren e 2-të buxhetore të brendshme komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi limitet e shpenzimeve dhe Qarkoren e 3-të buxhetore të brendshme komunale e cila përmban orarin për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Ministria e Financave deri më 15 gusht nxjerr Qarkoren buxhetore të 2-të e cila siguron udhëzimet përfundimtare buxhetore dhe nivelet përfundimtare të granteve.

Kryetari i komunës deri më datë 1 shtator, ia dorëzon kuvendit të komunës propozim buxhetin për vitin e ardhshëm. Kuvendi i komunës deri më 30 shtator duhet të aprovojë dhe t`ia dorëzojë Ministrisë së Financave buxhetin e komunës për vitin e ardhshëm.

Qeveria pasi e miraton propozim Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore, ia dorëzon Kuvendit të Kosovës deri më 31 tetor. Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin për vitin e ardhshëm deri më datën 31 dhjetor.

Krahas të gjitha këtyre procedurave dhe afateve kohore, nëse ndodh planifikimi joadekuat mund të bëhet procesi i rishikimit të buxhetit. Vendimi për ndërmarrjen e një veprimi të tillë si dhe afati kohor për realizimin e saj bëhet me udhëzime të veçanta të Minisitrisë së Financave.

Buxheti dhe Anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendi të Komunës duhet të kenë informata të hollësishme mbi secili hap të procesit të planifikimit të buxhetit të komunës sepse afati kohor prej 30 ditësh në mes të datës 1 shtator dhe datës 30 shtator nuk është i mjaftueshëm për anëtarët e kuvendit të komunës që të sigurohen se propozim buxheti i pranuar nga kryetari i komunës është në përputhje me kërkesat e qytetarëve të komunës. Në këtë kontekst, kuvendi i komunës duhet ta ftojë zyrtarin kryesor financiar në afatet përkatëse që anëtarëve të kuvendit të komunës tu japë informata mbi qarkoret buxhetore. Në të njëjtën kohë, anëtarët e kuvendit të komunës këto informata mund t'i gjejnë në Ministrinë e Financave dhe në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të komunës së tyre.



Rolet e institucioneve të komunës në planifikim dhe implementim të buxhetit

Kryetari i Komunës i dërgon kuvendit të komunës projekt buxhetin vjetor dhe buxhetin e miratuar për aprovim.

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxhetit komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime kuvendit të komunës.

Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga komiteti për politikë dhe financa, të shqyrtojë, dhe në rast pajtimi, të miratojë, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale.

Planifikimi i buxhetit duhet t'i përmbahet disa parimeve: Të jetë i targetuar ashtu që merr për bazë nevojat specifike të grupeve të caktuara dhe të margjinalizuara të shoqërisë.

Të jetë gjithëpërfshirës sepse nuk mund të flasim për buxhetim të targetuar pa buxhetim gjithëpërfshirës - si mund t`i kuptojmë nevojat e grupeve të ndryshme të shoqërisë pa i përfshirë ata në procesin e planifikimit të buxhetit.

Të jetë transparent ka të bëjë me lejimin e qasjes së publikut në të gjitha fazat e buxhetimit duke përfshirë fazën e planifikimit por edhe të realizimit të buxhetit të komunës. Transparenca nënkupton që buxheti të jetë jo vetëm lehtësisht i qasshëm, por duhet që të përpilohen formate të thjeshtëzuara lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë.

Duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore në buxhetin vjetor për vitin 2018. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Duhet të merrni parasysh këto udhëzime në nxjerrjen e qarkores së brendshme buxhetore komunale, si dokument bazë për planifikimin e buxhetit tuaj komunal për periudhën 2018-2020. Nëse ka paqartësi në këtë drejtim, organizatat buxhetore mund të konsultohen me analistët përkatës në kuadër të Departamentit të Buxhetit në Ministrinë e Financave.

KOMUNA E LIPJANIT

KËRKESAT DHE PRIORITETET E QYTETAREVE GJATË VITIT 2021

Komuna e Lipjanit në kuadër të planifikimit të buxhetit komunal për tri vitet e ardhshme 2022/24 dhe në bashkëpunim me YAHR kanë organizuar takime me qytetarë në formën e dëgjimeve buxhetore , ku nga data 8-11 qershor 2021 ka organizuar 11 dëgjime buxhetor dhe nga data 11 – 12 gusht 2021 ka organizuar 4 dëgjime buxhetor. Në këto dëgjime kanë marrë pjesë gjithsej 224 qytetarë, ku prej tyre 191 ose 85.27% burra dhe 33 ose 14.73% gra.

KËRKESAT DHE PRIORITETET E QYTETAREVE GJATË VITIT 2021

INFRASTRUKTURË RRUGORE

Kërkesat e qytetareve në infrastrukturë rrugore nga dëgjimet buxhetore ishin gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kërkesa, ku nga të cilat vetëm katërmbëdhjetë (14) prej tyre janë përfshirë në planifikimin e buxhetit komunal nga ana e komunë së Lipjanit. Në tri (3) kërkesa është specifikuar vendbanimi dhe shuma e mjeteve të nevojshme për realizimin e këtyre projekteve.. Në fshatin Akllap për dy vitet e ardhshme është ndarë shuma prej 60 mijë euro, në Magurë dhe në Shalë janë paraparë 90 mijë euro.

Ndërsa, në njëmbëdhjetë (11) kërkesat tjera nuk është specifikuar vendi përveç shumëse se mjeteve të ndara për këto projekte e cila arrin në vlerën prej 6 milion euro.

UJË DHE KANALIZIM

Kërkesa e daluar nga qytetaret për ujë dhe kanalizim kanë qenë gjithsej nëntë (9), ku tetë (8) prej tyre janë të përfshira në planifikimin e buxhetit komunal, ndërsa vetëm një (1) është specifikuar saktë dhe atë për fshatin Leletiq me shumen e mjeteve prej 155 mijë euro dhe atë për dy vitet e ardhshme 2022/23. Ndërsa, shtatë (7) kërkesat tjera të përfshira në buxhetin komunal nuk janë specifikuar vendi, por është ndarë vetëm shuma e mjeteve të përgjithësuar e cila arrin në vlerën prej 1.5 milion euro.

SHKOLLA

Ndërsa, kërkesa nga qytetarët në fushën e arsimit kanë qenë gjithsej nëntë (9), nga të cilat vetëm tri (3) janë përfshirë në buxhetin komunal dhe të specifikuara saktë. Kërkesa e pare është për rregullimin e oborrit të shkollës në fshatin Kraishtë me shumen e mjeteve prej 155 mijë euro, ndërsa kërkesa e dyte është për ndërtimin e Çerdhes në fashitin Shalë me shumën e mjeteve prej 260 mijë euro, kërkesa e tretë është po ashtu në fshatin Shalë për rregullimin dhe renovimin e shkollës me mjetet e ndara prej 75 mijë euro.

KULTURË, RINI DHE SPORT

Kërkesat e qytetareve për Kulture rini dhe sport janë gjithsej tetë (8), ku nga këto janë vetëm tri (3) kërkesa të përfshira në buxhetin e komunës së Lipjanit dhe janë të specifikuar saktë në buxhetin e paraparë për vitin 2022. Kërkesa e pare është për fshatin Magurë, kompleksi sportiv me shumen e mjeteve të ndarë prej 55 mijë euro, kërkesa e dyte është fushë sportive në fshatin Gllavic dhe Marevc me shumën e mjeteve të ndara prej 55 mijë euro, ndërsa kërkesa e tretë është po ashtu në fshatin Magurë ku është kërkuar fushë sportive në vlerën prej rreth 55 mijë euro.



Kërkesat në fushën e shëndetësi kanë qenë gjithsej pesë (5) kërkesa, ku nga këto janë përfshirë vetëm dy (2) prej tyre në planifikimin buxhetore dhe të specifikuara sakte për nga vendbanimi dhe shuma e paraparë e mjeteve për këto projekte. Kërkesa e parë është zgjerimi i shërbimeve laboratorike në QMF-Magurë me shumën e mjeteve prej 200 mijë euro për 3 vitet e ardhshme 2022/24, kërkesa e dyte është për renovimin e ishe ambulantes në Shalë me 81 mijë euro.



Kërkesa në fushën e sigurisë nga qytetaret kanë qenë rreth tri (3) kërkesa, mirëpo komuna e Lipjanit as njërën nga këto kërkesa nuk e ka përfshirë në planifikimin buxhetor.



Në fushën e ambientit qytetaret e komunës së Lipjanit kanë parashtruar tetëmbëdhjetë (18) kërkesa, ku vetëm katër (4) prej tyre janë përfshirë në planifikimin buxhetor komunal. Tri (3) kërkesa janë të specifikuara saktë për nga lokacioni dhe shuma e parapara e mjeteve për këto projekte. Kërkesa e pare është rregullimi i shtrati të lumit në Gadime ku janë ndarë 170 mijë euro për dy vitet e ardhshme, ndërsa kërkesa e dyte është për hapësirat rekreative sportive dhe kënd të lojërave në fshatin Magurë ku janë ndarë 260 mijë euro për dy vitet e ardhshme 2022/23 dhe kërkesa e tretë është në fshatin Shalë për rregullimin e një parku rekreative me 260 mijë euro për dy vitet e ardhshme. Ndërsa kërkesa e katërt e cila nuk është

e specifikuar saktë lokacioni është për parqet nëpër disa fshatra dhe hapësira të gjelbëruar dhe kënde të lodrave, ku shuma e mjeteve e ndarë për këto projekt është prej 305 mijë euro.

PËRFSHIRJA E PRIORITETEVE TË QYTETAREVE NË KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2022/24

Në bazë të monitorimit nga organizata YAHR ka nxjerrë statistika dhe duke u bazuar në të dhënat lidhur me përfshirjen e kërkesave të qytetareve në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2022/24. Ku Kuvendi i Komunës së Lipjanit nga 71 kërkesa nga qytetareve të dalura nga Dëgjimet Buxhetore, i ka përfshirë vetëm 11 kërkesa ose 16 % prej tyre, ndërsa 25 kërkesa ose 36 % mund të jenë të përfshira, por që nuk janë përmendur saktësisht lokacioni i vendbanimeve se ku do të realizohet projektet dhe 35 ose 48 % të kërkesave nuk janë të përfshira fare në planifikime buxhetore për vitet 2022/24.

PËRFSHIRJA E PRIORITETET E QYETARËVE TË LIPJANIT NË KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2022/24

Kategoritë	*Të përfshira*	*Jo specifikisht të përfshira*	*Të pa përfshira*
INFRASTRUKTURË RRUGORE	*3*	*12*	*3*
UJË DHE KANALIZIM	*1*	*7*	*1*
SHKOLLA	*2*	*1*	*6*
KULTURË, RINI DHE SPORT	*3*	*0*	*5*
SHËNDETËSI	*1*	*1*	*4*
SIGURI	*0*	*1*	*2*
AMBIENT	*1*	*3*	*14*
GJITHSEJ	*11*	*25*	*35*

KOMUNA E SHTIMES

KËRKESAT DHE PRIORITETET E QYTETAREVE GJATË VITIT 2021

Komuna e Shtimes organizon përherë të parë ka organizuar dëgjime buxhetore për qarkoren e parë, që në të kaluarën nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Komuna e Shtimes ka organizuar 8 Dëgjime Buxhetore gjatë periudhës 14–21 qershor 2021, por janë mbajtur vetëm dy, ndërsa të tjerat janë anuluar për shkak të mos pjesëmarrjes së qytetareve në takime.

KËRKESAT DHE PRIORITETET E QYTETAREVE GJATË VITIT 2021

INFRASTRUKTURË RRUGORE

Kërkesat e qytetareve të komunës së Shtimes në fushën e infrastrukturës rrugore kanë qenë tri (3) kërkesa, ku komuna në planifikimin buxhetore e ka përfshirë vetëm një (1) prej tyre dhe ajo është për rregullimin e sinjalistikës nëpër rrugët e fshatit Petrovë, shuma e mjeteve të ndara për këtë projekt është 30 mijë euro.

UJË DHE KANALIZIM

Kërkesa për ujë dhe kanalizim të qytetareve të komunës së Shtimes kanë qenë tri (3) kërkesa ku komuna e Shtimes i ka planifikuar në buxhetin komunal vetëm dy (2) prej tyre të cilat janë të specifikuar saktë për nga lokacioni dhe shuma e mjeteve të ndara për këto projekte. Kërkesa e parë është për kanalizimin në fshatin Gjurkovc në shumen prej 13 mijë euro, ndërsa kërkesa e dytë është po ashtu për kanalizim në fshatin Muzeqinë në shumen e paraparë për 3 vitet e ardhshme prej 60 mijë euro.

SHKOLLA

Në fushën e arsimit komuna e Shtimes nuk ka përfshirë asnjë planifikim buxhetore për 3 vitet e ardhshme pavarësisht se ka qenë një (1) kërkesë nga qytetaret e kësaj komune.



Kërkesa në fushën e sigurisë nga qytetaret e komunës së Shtimes kanë qenë rreth tri (3) kërkesa, mirë po që komuna e Shtimes nuk ka paraparë as një projekt në planifikimin buxhetore të komunës.

Në fushën e ambientit qytetaret e komunës së Shtimes i kanë parashtruar dy (2) kërkesa, ku vetëm njërën e ka përfshirë në planifikimin buxhetore, të cilën e ka specifikuar sakte për nga lokacioni dhe shuma e paraparë për 3 vitet e ardhshme. Kërkesa është për fshatin Muzeqinë ku është kërkuar të rregullohet dhe të mirëmbahet parku i fshatit mjetet e ndara për këtë projekt janë rreth 60 mijë euro.

PËRFSHIRJA E PRIORITETEVE TË QYTETAREVE NË KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE 2022/24

Në Komunën e Shtimes kemi pasur 11 kërkesa nga qytetarët, 2 ose 17 % të përfshira, 3 ose 25 % të përgjithësuar dhe 7 ose 58 % jo të përfshira në qarkoren e parë buxhetore.



SHTOJCAT:

Tabela 1. Në vijim pasqyron kërkesat sipas kategorive, dhe përfshirjen e tyre në buxhet e Komunës së Lipjanit:

Me ngjyrë të portokalltë janë parashikuar mjete por nuk kemi të specifikuar lokacionin se në cilin vendbanim do të bëhet investimi.

Me ngjyrë të gjelbër janë parashikuar mjete dhe është specifikuar lokacioni

Lloji i prioritetit	#	Prioriteti i qytetarëve	Lokacioni dhe data e dëgjimit publik	Përfshirë në buxhetin për 2022	Përfshirë në KAB 2023	Përfshirë në KAB 2024	TOTALI
INFRASTRUKTURË RRUGORE	1	Asfaltimin e rrugicave	Banullë, data 08.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	2	Trotuar dhe ndriçim publik	Banullë, data 08.06.2021		70,000.00	240,000.00	310,000.00
	3	Të ngritët niveli i urave në fshat	Banullë, data 08.06.2021				
	4	Trotuar dhe ndriçim publik	Kraishtë, data 08.06.2021		70,000.00	240,000.00	310,000.00
	5	Rregullimi i urave	Akllap, data 09.06.2021	25,000.00	35,000.00		60,000.00
	6	Trotuar me ndriçim publik	Gadime, data 09.06.2021		70,000.00	240,000.00	310,000.00
	7	Asfaltim i rrugicave me kanalizim - Marevc	Gadime, data 09.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	8	Rregullimi i dy urave	Magurë, data 10.06.2021				
	9	Asfaltim të rrugicave	Magurë, data 10.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	10	Asfaltim të rrugicave - Mirenë	Magurë, data 10.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	11	Trotuar, ndriçim publik - Mirenë	Magurë, data 10.06.2021	75,000.00	15,000.00		90,000.00
	12	Rregullimin e urës – Leletiq	Magurë, data 10.06.2021				
	13	Asfaltim i rrugicave – Qylagë	Magurë, data 10.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	14	Asfaltim të rrugicave – Blinajë	Magurë, data 10.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	15	Asfaltim i rrugicave – Medvec	Magurë, data 10.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	16	Asfaltim të rrugicave – Vrellë	Magurë, data 10.06.2021	170,000.00	146,646.00	284,820.00	601,466.00
	17	Trotuar dhe ndriçim publik në drejtim të Baicëse	Shalë, data 10.06.2021		70,000.00	240,000.00	310,000.00
	18	Ndriçim publik – Baincë	Shalë, data 10.06.2021	75,000.00	15,000.00		90,000.00
UJË DHE KANALIZIM	19	Rregullimin e kanalizimin tek objekti i shkollës dhe rregullimin e oborrit të shkollës	Banullë, data 08.06.2021	80,000.00	75,000.00	85,000.00	240,000.00
	20	Zgjerim i kanalizimit	Akllap, data 09.06.2021	80,000.00	75,000.00	85,000.00	240,000.00
	21	Sanim i problemeve në kanalizim	Gadime, data 09.06.2021				
	22	Funksionalizim i ujësjellësit	Gadime, data 09.06.2021	65,000.00	50,000.00	50,000.00	165,000.00
	23	Sanim i problemeve në kanalizim	Magurë, data 10.06.2021	80,000.00	75,000.00	85,000.00	240,000.00
	24	Zgjerim të kanalizimit - Mirenë	Magurë, data 10.06.2021	80,000.00	75,000.00	85,000.00	240,000.00
	25	Ujësjellës – Leletiq	Magurë, data 10.06.2021	60,000.00	95,000.00		155,000.00

	26	Sanim i ujërave të zeza – Qylagë	Magurë, data 10.06.2021	80,000.00	75,000.00	85,000.00	240,000.00
	27	Ujësjellës – Vrellë	Magurë, data 10.06.2021	65,000.00	50,000.00	50,000.00	165,000.00
SHKOLLA	28	Arsimi të jete prioritet komunal	Lipjan, data 08.06.2021				
	29	Shkollën e vjetër se bashku me komunën të shikohet për ridestinimin e saj	Banullë, data 08.06.2021				
	30	Rregullimin e oborrit të shkollës	Kraishtë, data 08.06.2021		15,000.00	140,000.00	155,000.00
	31	Shkollë të mesme të ulte	Gadime, data 09.06.2021				
	32	Çerdhe	Magurë, data 10.06.2021				
	33	Rrethoj për shkollë – Leletiq	Magurë, data 10.06.2021				
	34	Çerdhe	Shalë, data 10.06.2021		100,000.00	160,000.00	260,000.00
	35	Renovim i shkollës, rregullim i oborrit dhe rrethoja	Shalë, data 10.06.2021	60,000.00	15,000.00		75,000.00
	36	Zgjerim i shkollës – Baincë	Shalë, data 10.06.2021				
KULTURË, RINI DHE SPORT	37	Kërkesë për fshatin Magure ku është kërkuar një kompleks sportiv me ndriçim publik	Lipjan, data 08.06.2021	55,000.00			55,000.00
	38	Organizatat e shoqërisë civile kanë kërkuar bashkëpunim me komunën e Lipjanit	Lipjan, data 08.06.2021				
	39	Sallë sportive afër shkollës së vjetër	Banullë, data 08.06.2021				
	40	Fushë sportive në mes të dy fshatrave Gllavica-Marevc	Gadime, data 09.06.2021	55,000.00			55,000.00
	41	Fushë sportive	Magurë, data 10.06.2021	55,000.00			55,000.00
	42	Fushë sportive – Blinajë	Magurë, data 10.06.2021				
	43	Mundësia e një zyre për aktivitete e të rinjëve dhe grave	Shalë, data 10.06.2021				
	44	Sallë sportive - Baincë	Shalë, data 10.06.2021				
SHËNDETËSI	45	Shëndetësia	Lipjan, data 08.06.2021				
	46	Të subvencionohen familjet të cilat kanë fëmijë të sapo lindur	Lipjan, data 08.06.2021				
	47	Një kërkesë tjetër ka qenë për harmonizimin e shtëpive të shëndetit që të kenë një harmoni të punese që bëhet në këto qendra.	Lipjan, data 08.06.2021				
	48	Zgjerim i shërbimeve laboratorike në QMF-Magurë	Magurë, data 10.06.2021	40,000.00	60,000.00	100,000.00	200,000.00
	49	Renovim i ish-ambulantës	Shalë, data 10.06.2021	31,741.00		50,000.00	81,741.00
	50	Largimin e qenve endacak	Banullë, data 08.06.2021				
SIGURI	51	Pengesa në rrugën afër shkollës	Magurë, data 10.06.2021				
	52	Vendqëndrim për autobusë	Shalë, data 10.06.2021				
AMBIENT	53	Investimi në fshatra për hapësirat e gjelbërta	Lipjan, data 08.06.2021				

	54	Parqe nëpër fshatra dhe hapësira të gjelbëruar dhe kënd të lojërave	Lipjan, data 08.06.2021	65,000.00	85,000.00	155,000.00	305,000.00
	55	Rregullimin e lumit Sitnica në Rubofc	Lipjan, data 08.06.2021				
	56	Hapjen e një pjese të lumit	Banullë, data 08.06.2021				
	57	Hapësira të gjelbëruar	Kraishtë, data 08.06.2021				
	58	Rregullim i shtratit të lumit	Gadime, data 09.06.2021	50,000.00	120,000.00		170,000.00
	59	Vazhdim i rregullimit të lumit	Magurë, data 10.06.2021				
	60	Kontejnerë afër tregut	Magurë, data 10.06.2021				
	61	Hapësirë rekreative dhe kënd të lojërave	Magurë, data 10.06.2021		80,000.00	180,000.00	260,000.00
	62	Funksionalizimin e shëtitores	Magurë, data 10.06.2021				
	63	Rregullim të lumit - Mirenë	Magurë, data 10.06.2021				
	64	Rregullimi i shtrati të lumit - Qylagë	Magurë, data 10.06.2021				
	65	Murosjen e lumit - Blinajë	Magurë, data 10.06.2021				
	66	Murosjen e lumit – Medvec	Magurë, data 10.06.2021				
	67	Rregullimi i lumit dhe shëtitore	Shalë, data 10.06.2021				
	68	Fontanë dhe renovim i sheshit	Shalë, data 10.06.2021				
	69	Park rekreativ	Shalë, data 10.06.2021		80,000.00	180,000.00	260,000.00
	70	Vendosje të shportave për mbeturina	Shalë, data 10.06.2021				

Tabela 2 Në vijim pasqyron kërkesat sipas kategorive, dhe përfshirjen e tyre në buxhet e Komunës së Shtimes:

Me ngjyrë të portokalltë janë parashikuar mjete por nuk kemi të specifikuar lokacionin se në cilin vendbanim do të bëhet investimi.

Me ngjyrë të gjelbër janë parashikuar mjete dhe është specifikuar lokacioni

Lloji i prioritetit	#	Prioriteti i qytetarëve	Lokacioni dhe data e dëgjimit publik	Përfshirë në buxhetin për 2022	Përfshirë në KAB 2023	Përfshirë në KAB 2024	
INFRASTRUKTURË RRUGORE	1	Rregullimi i sinjalistikes nëpër rrugë	Petrovë, data 15.06.2021	10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00
	2	Zgjerimi i rrugëve të fshatit	Muzeqinë, data 15.06.2021				
	3	Asfaltimi I rrugës "Haxhi Halimi"	Muzeqinë, data 15.06.2021				
UJË DHE KANALIZIM	4	Funksionalizimi i furnizimit me ujë të pijshëm	Petrovë, data 15.06.2021				
	5	Kanalizim	Gjurkovc, data 15.06.2021	13,500.00			13,500.00
	6	Kanalizim	Muzeqinë, data 15.06.2021	20,000.00	20,000.00	20,000.00	60,000.00
SHKOLLA	7	Transportimi i nxënësve	Muzeqinë, data 15.06.2021				
SIGURI	8	Ndërrimi i sistemit të furnizimit me energji elektrike	Petrovë, data 15.06.2021				
	9	Ndërrimi i shtylla elektrike	Muzeqinë, data 15.06.2021				
	10	Vendosja e pengesave në rrugë	Muzeqinë, data 15.06.2021				
AMBIENT	11	Rregullimi dhe mirëmbajtja e parkut të fshatit	Muzeqinë, data 15.06.2021	20,000.00	20,000.00	20,000.00	60,000.00
	12	Rregullimi i shtratit të lumit	Muzeqinë, data 15.06.2021				

ORGANIZATA YAHR:

Asociacioni i të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YAHR) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, e themeluar në fillim të vitit 2000 por ajo është regjistruar vetëm në 21 Tetor 2002 në nivelin qendror. Nisma për krijimin e organizatës ishte nevoja për të ndërtuar një shoqëri demokratike me mundësi të drejta dhe të barabarta për të gjithë qytetarët. Të drejtat dhe mundësitë e barabarta në një shtet demokratik shkojnë së bashku me përgjegjësitë qytetare që secili qytetar i jep vendit dhe shtetit të tij. Duke u bërë pjesë e shoqërisë, ne përpiqemi të luajmë një rol aktiv në përmirësimin e jetës së qytetarëve përmes mbikëqyrjes së qeverisë dhe presionit për të prodhuar politika të mira publike të cilat synojnë të përmirësojnë jetën e të gjithë qytetarëve pa diskriminim.

Përgjatë viteve të funksionimit si një nga organizatat më aktive lokale, YAHR është profilizuar si një entitet mbikëqyrës (watchdog) duke mirëmbajtur kontrollin efektiv publik, fillimisht mbi Komunën e Lipjanit, e me kalimin e viteve edhe në ato të Shtimes dhe Ferizajit. YAHR është specializuar në monitorimin e punës së organeve komunale (legjislativ dhe ekzekutiv) dhe ka prodhuar një numër të madh raportesh që dëshmojnë për ecurinë e qeverisjes lokale. Një nga ndikimet kryesore të punës së YAHR ka qenë hapja e komunave në raport me qytetarët, pra fuqizimi i transparencës publike dhe në të njëjtën kohë rritja e kërkesës publike për më shumë llogari. Kjo qasje e organizatës ka ndikuar edhe në aktivizimin e grupeve të komunitetit në komunat përkatëse. Në komunën e Lipjanit është vërejtur rritje e interesimit qytetar, bashkë me formimin e grupeve të reja të komunitetit që kanë intensifikuar komunikimin me institucionet komunale, krahas rritjes së kërkesave.

YAHR beson që përgjatë këtyre viteve ka ofruar një kontribut të konsiderueshëm në avancimin e agjendës së demokratizimit në këto komuna, me theks në komunën e Lipjanit. Në të njëjtën kohë, organizata beson që ka shërbyer edhe si model për grupet të rinjsh, duke nxitur aktivizimin e tyre në çështje lokale që kanë rëndësi për komunitetin. Nuk duhet harruar as rolin që YAHR ka luajtur në nivel kombëtar, si pjesë e programeve të partneritetit, rrjeteve të shoqërisë civile dhe prezencës aktive mediale, në avancimin e demokracisë lokale. YAHR është e vetëdijshme që angazhimi i organizatave të shoqërisë civile është vështirë i matshëm në shtigje të shkurtra, pasi misioni i asaj pjese të shoqërisë civile që punon për demokratizim para se gjithash përkon me ndërrimin e mendësisë si të qytetarëve ashtu edhe të atyre që janë në pozita të pushtetit. Ndryshimi i kulturës së përgjithshme politike dhe shndërrimi i qytetarit në aktivistin që e sfidon në baza të rregullta pushtetit, si dhe shndërrimi i bartësit të një pozitë publike në shërbëtorin që në baza ditore kujdeset për cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarit, është sfidë sa komplekse, aq edhe e shtrirë në kohë.

Donatoret nga 2002-2021: OSCE, UNHCR, Save the Children, Worldvision, ATRC/IREX, OHCHR, Balkan Green Foundation (BGF), Institute for Development Policy (INDEP), Balkan Public Finance Monitoring, German Embassy in Pristina, Metamorphosis Foundation, Westminster Foundation for Democracy, CRTA – Center for Research, Transparency and Accountability, Center for Democratic Transition, Open Data Kosovo (ODK) U.S. Embassy in Pristina, USAID, UNDP, World Bank, Swiss Agency for Development (SDC) and Olof Palme International Center .

BURIMET:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Mars 2021 – janar 2022..
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Mars 2021 – janar 2022.
3. https://kk.rks-gov.net/lipjan/
4. https://kk.rks-gov.net/shtime/
5. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Mars 2021 – janar 2022.
6. Komunikatat për media të YAHR-it Mars 2021 – janar 2022..
7. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendeve Komunal të Lipjanit dhe Shtimes, Mars 2021 – janar 2022..
8. http://kk.rks-gov.net/Lipjan/
9. https://www.youtube.com/channel/UCmDXxB6d1n6gXGtEiowljQQ

Ky aktivitet përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkë financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.